



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 920/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Ibrahim Kadri nga subjekti politik Lista e Ashkalive me seli ne Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.920/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Ibrahim Kadri nga subjekti politik Lista e Ashkalive me seli ne Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Ibrahim Kadri nga subjekti politik Lista e Ashkalive me seli ne Ferizaj, me të cilën pretendon se sipas rezultateve të publikuara nga KQZ-ja parashtruesi i apelit thekson se i ka 188 vota ku renditet i treti me vote ne listën e subjektit politik ne fjale, ndërsa sipas fletave te FPR-ve ne ueb faqen e KQZ-se dhe sipas kontrollit te kopjeve te FPR-ve te cilat i ka kontrolluar flet për flet parashtruesi i apelit thekson se i ka pasur 182 vota, po ashtu edhe kandidati Naxhim Kraka nga i njëjti subjekt politik i kishte 182 vota ne FPR, ku sipas informatave qe posedon nga vëzhguesit dhe shtabi i tyre 8 vota me kusht ishin për parashtruesin e apelit pra Ibrahim Kadriun qe d.m.th. 190 vota duhen te jene ne rezultatin final dhe për këtë arsye kërkon qe votat me kusht te rishikohen dhe një here për subjektin e tyre politik sepse provat dhe qëndrimi i tyre është se parashtruesi i apelit Ibrahim Kadri është kandidati me i votuar pas bartëses se listës ne listën e Ashkalive dhe dallimi final i publikuar nga KQZ-ja mes Ibrahim Kadri dhe Naxhim Kraka është një (1) votë më shumë për kandidatin Naxhim Kraka, kurse sipas fakteve të parashtruesit të apelit tregojnë qe ai pra Ibrahim Kadri duhet te ketë 190 vota kurse kandidati Naxhim Kraka 188.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, Ibrahim Kadri nga subjekti politik Lista e Ashkalive me seli ne Ferizaj, me të cilën kërkon rinumërim të votave është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.920/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.